REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

DETYRAT E ADMINISTRATËS SË NJËSIVE ADMINISTRATIVE (LIGJI 139/2015)

Në Njësitë Administrative funksionon administrata që drejtohet nga Administratori.
Administratori emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari i Bashkisë dhe është përgjegjës para tij për funksionimin dhe veprimtarinë e administratës. Administratori duhet të ketë vendbanimin në Njësinë Administrative përkatëse.

Struktura dhe organika e administratës së Njësive Administrative janë pjesë të strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë.

a) është zyrë e shërbimit për të gjitha procedurat administrative në kompetencën e bashkisë;

b) mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin;

c) mbështet punën e strukturave kompetente të bashkisë;

ç) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë parqet, lulishtet dhe zonat e gjelbëruara;

d) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë tregjet publike;

dh) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë këndet e lojërave, terrenet sportive, bibliotekat, shtëpitë dhe klubet e rinisë;

e) përgatit dhe i propozon kryetarit të bashkisë planin për investimet nën juridiksionin e saj territorial, si dhe mbikëqyr, pas miratimit, zbatimin e tyre, sipas ligjit;

ë) propozon, sipas ligjit, emërtimin e rrugëve, shesheve, institucioneve dhe objekteve që janë nën juridiksionin e saj territorial;

f) mbështet, koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e kryetarëve e të kryesive të fshatrave;

g) i propozon kryetarit të bashkisë dhënien e titujve të nderit dhe stimujve për personat nën juridiksionin e saj territorial;

gj) propozon marrjen e nismave në dobi të komunitetit me mundësi të barabarta dhe përfitime nga të gjithë brenda juridiksionit të saj territorial;

h) kryen çdo funksion tjetër të deleguar nga Kryetari i Bashkisë.

***Adresa**: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Bashkia Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al